



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-CC-2023-22

**Vendosi:** Kryetarja e Dhomave të Specializuara  
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

**Data:** 22 nëntor 2023

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Konfidencial

---

## Vendim për Caktimin e Gjykatësve të Panelit të Gjykatës Kushtetuese

---

### Gjykatësve të Panelit të Gjykatës Kushtetuese:

Gjykatës Vidar Stensland  
Gjykatës Roumen Nenkov  
Gjykatëse Romina Inkuti

### Prokurores së Specializuar:

Kimberli P. Uest

### Mbrojtjes së Nasim Haradinajt:

Tobi Kadman

**KRYETARJA** e Dhomave të Specializuara ("Kryetarja"), në bazë të nenit 33(3) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, ("Ligji") dhe rregullave 3 dhe 4(2) të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve të Dhomave të Specializuara nga Regjistri i Gjykatësve Ndërkombëtarë ("Rregullorja për Caktimin e Gjykatësve"), me anë të këtij vendimi cakton Panelin e Gjykatës Kushtetuese për të vendosur mbi Kërkesën Referuese të Mbrojtjes së Haradinajt drejtuar Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese ("Kërkesa Referuese").<sup>1</sup>

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 18 maj 2022, Trupi Gjykues II ("Trupi Gjykues") shqiptoi Aktgjykimin në çështjen gjyqësore kundër z. Hysni Gucati dhe z. Nasim Haradinaj.<sup>2</sup> Trupi Gjykues i shpalli fajtorë të dy të akuzuarit për pengim të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, frikësim gjatë procedurës penale dhe shkelje të fshehtësisë së procedurës, dhe i dënoi ata me katër vjet e gjysmë burgim, duke llogaritur kohën e kaluar në paraburgim, dhe secilin me një gjobë prej 100 eurosh.<sup>3</sup>

2. Më 2 shkurt 2023, Paneli i Gjykatës së Apelit lëshoi Aktgjykimin e Apelit në çështjen gjyqësore kundër z. Gucati dhe z. Haradinaj.<sup>4</sup> Paneli i Gjykatës së Apelit la në fuqi pjesën më të madhe të verdikteve të fajësisë së z. Gucati dhe z. Haradinaj dhe prapësoi verdiktet e fajësisë për veprën penale të pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare përmes pjesëmarrjes në veprimin e përbashkët të një grupi.<sup>5</sup> Duke pasur parasysh konstatimin e vet, Paneli i Apelit, me shumicë, i uli dënimet e dhëna nga Trupi Gjykues nga katër vjet e gjysmë në katër vjet e tre muaj burgim, duke

---

<sup>1</sup> KSC-CC-2023-22/F00001, Kërkesë Referuese e Mbrojtjes së Haradinajt drejtuar Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese, 21 nëntor 2023 (konfidenciale).

<sup>2</sup> KSC-BC-2020-07, F00611/RED, Version i Redaktuar Publik i Aktgjykimit, 18 maj 2022.

<sup>3</sup> Aktgjykimi, para. 1012-1017.

<sup>4</sup> KSC-CA-2022-01, F00114, Aktgjykimi i Apelit, 2 shkurt 2023.

<sup>5</sup> Aktgjykimi i Apelit, para. 442.

llogaritur kohën e kaluar në paraburgim.<sup>6</sup> Paneli i Apelit la në fuqi dënimin shtesë për z. Gucati dhe z. Haradinaj me një gjobë prej 100 eurosh secili.<sup>7</sup>

3. Më 18 shtator 2023, Paneli i Gjykatës Supreme lëshoi Vendimin mbi Kërkesat për Mbrojtjen e Ligjshmërisë, me të cilin rrëzoi në tërësi kërkesën e z. Haradinaj për mbrojtjen e ligjshmërisë, duke konstatuar se nuk ka shkelje të së drejtës penale të përfshirë në Ligj, ose shkelje thelbësore të procedurave të përcaktuara në Ligj dhe Rregulloren e Procedurave dhe të Provave.<sup>8</sup>

4. Më 21 nëntor 2023, z. Haradinaj dorëzoi Kërkesën Referuese.

## II. CAKTIMI

5. Në bazë të nenit 33(3) të Ligjit, pas parashtrimit të kërkesës referuese në Dhomën e Specializuar të Gjykatës Kushtetuese ("DHSGJK"), caktohen tre gjykatës të DHSGJK-së. Në rast se njëri nga këta gjykatës nuk është në dispozicion për kryerjen e detyrës, Kryetarja cakton një gjykatës kushtetues rezervë.

6. Kryetarja konstaton se një nga tre gjykatësit e DHSGJK-së nuk është në dispozicion për kryerjen e detyrës. Rrjedhimisht, Kryetarja cakton gjykatësin kushtetues rezervë në përputhje me nenin 33(3) të Ligjit dhe rregullën 4(2) të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve.

## III. KLASIFIKIMI

7. Kërkesa Referuese është klasifikuar si konfidenciale dhe, për rrjedhojë, edhe ky vendim do të ketë të njëjtin klasifikim në përputhje me rregullën 82(4) të Rregullores, derisa të riklasifikohet më vonë në përputhje me rregullën 3(4) të Rregullores për

---

<sup>6</sup> Aktgjykimi i Apelit, para. 442.

<sup>7</sup> Aktgjykimi i Apelit, para. 442.

<sup>8</sup> KSC-SC-2023-01/F00021, Vendim mbi Kërkesat për Mbrojtjen e Ligjshmërisë, 18 shtator 2023, para. 126.

Caktimin e Gjykatësve.

**PËR KËTO ARSYE, KRYETARJA ME KËTË VENDIM ÇAKTON**

**Gjykatësin Vidar Stensland**

**Gjykatësin Roumen Nenkov**

**Gjykatësen Romina Inkuti**

në Panelin e Gjykatës Kushtetuese për të vendosur mbi Kërkesën Referuese.

\_\_\_\_/nënshkrimi/\_\_\_\_

**Gjykatëse Ekaterina Trendafilova**

**Kryetare e Dhomave të Specializuara**

E mërkurë, 22 nëntor 2023

Në Hagë, Holandë